

# Prishtina me Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm



RAPORTI 2016

Prishtina  
po bëhet



Prishtinës i ka munguar planifikimi i mirëfilltë për ta drejtuar zhvillimin e qytetit në të mirë të qytetarëve. Për një periudhë 15-vjeçare, zhvillimi i Prishtinës ka ndodhur në mënyrë të paplanifikuar mirë me plane zhvillimore urbanistike, të cilat, ndonëse të mangëta, nuk janë respektuar. Projektet të pamenduara dhe pa ndërlidhje me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për qytetin.

Për të ndryshuar këtë praktikë të dëmshme për qytetin dhe qytetarët, i është dhënë përparësi dhe vëmendje e veçantë planifikimit hapësinor dhe urbanistik të komunës së Prishtinës dhe projekteve që ndërlidhen me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka bashkëpunuar me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit për hartimin e planeve hapësinore. Ka hartuar programe dhe detyra projektuese me bashkëpunëtorë dhe ekspertë për organizmin e konkurseve urbanistiko-arkitektonike.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në mesin e shumë programeve dhe projekteve të përfunduara, ka realizuara edhe këto:

- Konferenca e parë e investimeve, në bashkëpunim me sektorin privat “Të zhvillohem së bashku 2016”;
- “Tregu mobil i produkteve vendore”;
- Panairi “Blej shqip” 2016.

## Në kuadër të planifikimeve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, më 4 nëntor 2016, Komuna e Prishtinës organizoi për herë të parë konferencën e investimeve, në bashkëpunim me sektorin privat “Të zhvillohem së bashku 2016”.

Përmes kësaj konference, Komuna e Prishtinës paraqiti planin për përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve, duke ofruar shërbime cilësore dhe mundësi për zhvillim ekonomik.

Nga instrumentet kryesore që Komuna i ka në dispozicion për arritjen e këtyre qëllimeve, janë investimet kapitale në infrastrukturë.

Duke pasur parasysh se Komuna e Prishtinës ballafaqohet me probleme të shumta, në mes tyre janë edhe problemet e infrastrukturës, për shkak të mungesës së planifikimit të mirëfilltë dhe kufizimeve buxhetore, Komuna synon t'i jetësojë projektet infrastrukturore përmes bashkëpunimit me sektorin privat, përmes dy formave: dhënes për shfrytëzim afatgjatë dhe partneritetit publiko-privat. Këto lloje të partneritetit janë model i financimit për projekte të infrastrukturës publike.


Në këtë konferencë u promovua Komuna si partner publik, ndërsa partner privat mund të janë bizneset në pronësi private, korporatë, ose konzorcium i bizneseve me fushë specifike të ekspertizës. Ky bashkim me interes të të dy palëve, ofron mundësinë për ndërtimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve, duke shfrytëzuar kapitalin dhe ekspertizën private, si dhe resurset e sektorit publik, respektivisht Komunës së Prishtinës.

Kjo konferencë pati për qëllim informimin e investitorëve potencialë për projektet që Komuna e Prishtinës i ka caktuar me prioritet. Qëllimi, parametrat kryesore, përfitimet dhe avantazhet e secilit projekt, janë ofruar nga Komuna si pasqyrë e situatës dhe mundësive për investim.

Projektet e përzgjedhura me prioritet nga Komuna e Prishtinës janë:

Pishina olimpike, prapa Pallatit të Rinisë;  
Parkingu nëntokësor, te Fakulteti i Filologjisë;  
Çarshia e Vjetër, në qendër të Prishtinës;  
Kompleksi banesor dhe afarist, në rrugën "B" dhe  
Stacioni Qendoror në hyrje të qytetit.

# Pishina olimpike, prapa pallatit të Rinisë



Pishina olimpike parashihet të ndërtohet në qendër të Prishtinës, pranë qendrës, te Pallati i Rinisë. Sipërfaqja në dispozicion për ketë ndërtim është: 19,000 m<sup>2</sup>.

Qendra e Pishinave parashihet të përbehet nga:

- 1 Një pishinë olimpike (50m \* 25m); një pishinë për stërvitje (12m \* 6m); një pishinë për fëmijë (6m \* 6m); dhe shumë hapësira të tjera të cilat do ta bëjnë Qendrën e Pishinave funksionale dhe me qasje për të gjitha kategoritë e qytetarëve.
  - 2 Në Qendrën e Pishinave parashihet të ndërtohen edhe fusha sportive të sporteve të ndryshme.
  - 3 Parkingu nëntokësore, parashihet të ketë së paku 200 vendparkime dhe të ndërtohet deri në 2 nivele.
- Financimi i këtij projektit pritet të bëhet nga investitorët potencialë të sektorit privat.

Fushëveprimi i projektit: Kontrata e Koncesionit të partneritetit publiko-privat.

Shpenzimet kapitale për ketë investim janë: 15-16 milionë €.  
Kohëzgjatja e projektit: 30-45 vjet.

# Parkingu nëntokësor te Fakulteti i Filologjisë



Parkingu nëntokësor parashihet të ndërtohet në qendër (Zona 1) – përbalë Fakultetit të Filologjisë; afér kryqëzimit të bulevardit “Bill Clinton” dhe rrugës “George Bush”. Sipërfaqja në dispozicion për ketë ndërtim është: 14,000 m<sup>2</sup>. Parkingu nëntokësor kërcohët të ketë së paku 500 vendparkime dhe të ndërtohet parking nëntokësore deri në 2 nivele; Topografia do të përcaktojë numrin maksimal të dyqaneve që mund të ndërtohen. Përparësia e këtij parkingu është se do të jetë 5-10 minuta ecje deri në qendrën e qytetit.

Fushëveprimi i projektit: Kontrata e Koncesionit të partneritetit publiko-privat.

Shpenzimet kapitale për ketë investim janë: 10 – 10.5 milionë €.

Kohëzgjatja e Projektit: 35-40 vjet

# Çarshia e Vjetër, në qendër të Prishtinës



Planifikohet të jete në Zonën historike të qytetit të Prishtinës, Sipërfaqja: ~8600m<sup>2</sup>; Vendndodhja, afér Tregut të Gjelbër të tanishëm në Prishtinë. Parashihet që Çarshia e Vjetër t'i ketë 100 dyqane tregtare dykatëshe në zonën e alokuar, deri në 2 nivele (përdhes dhe kat të parë). Sipërfaqja e alokuar për parking nëntokësor është 1900m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e mbetur të përdoret si park, më një hapësirë të përbashkët për përdorime të ndryshme, si ngjarje kulturore dhe tubime shoqërore.

Fushëveprimi i projektit: Kontrata e Koncesionit të partneritetit publiko-privat.

Shpenzimet kapitale për ketë investim janë 2.8 – 3 milionë €.

Kohëzgjatja e Projektit: 25 vjet

## Kompleksi banesor dhe afarist, në rrugën "B"



Kompleksi banesor dhe afarist, në rrugën "B" parashihet të ketë dy objekte.

Në objektin banesore 1, parashihet të ndërtohet Stacioni i zjarrfikésve, në përdhesë. Sipërfaqja e parcelës:  $7,000 \text{ m}^2$ . Sipërfaqja për ndërtim:  $\sim 15,400 \text{ m}^2$ .

Në objektin banesor 2, parashihen të ndërtohen lokale afariste, garazhe nëntokësore dhe të ketë hapësirë publike.

Sipërfaqja për ndërtim:  $\sim 5,000 \text{ m}^2$ .

Në këtë ndërtim parashihet të jetë garazhi nëntokësor me 100 vendparkingje, lokalet afariste, hapësirë për sport dhe rekreacion me qasje për të gjithë. Po ashtu parashihet të ketë shtigje për këmbësorë, si dhe mundësi të lidhjes ndërmjet dy lokacioneve të propozuara.

Fushëveprimi i projektit: Dhënie e tokës, pronë publike, në shfrytëzim afatgjatë – më tepër se 15 vjet.

Shpenzime kapitale për ketë investim janë: 8 - 10 milionë €



# Stacioni qendror në hyrje të qytetit



Kompleksi banesor dhe afarist, në rrugën B, parashihet të ketë dy objekte.

Në objektin banesore 1, parashihet të ndërtohet Stacioni i zjarrfikësve, në përdhesh. Sipërfaqja e parcelës: 7,000 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja për ndërtim: ~ 15,400 m<sup>2</sup>.

Në objektin banesore 2, parashihet të ndërtohen lokale afariste, garazhe nëntokësore dhe të ketë hapësirë publike. Sipërfaqja për ndërtim: ~5,000 m<sup>2</sup>. Në ketë ndërtim parashihet të jetë garazhi nëntokësor me 100 vendparkingje, lokalet afariste, hapësirë për sport dhe rekreacion

me qasje për të gjithë. Po ashtu, parashihet të ketë shtigje për këmbësorë si dhe mundësi të lidhjes ndërmjet dy lokacioneve të propozuara.

Fushëveprimi i projektit: Dhënie e tokës, pronë publike, në shfrytëzim afatgjatë – më tepër se 15 vjet.

Shpenzime kapitale për këtë investim janë: 8 -10 milionë €

## **Komuna e Prishtinës synon t'i përmirësojë kushtet për zhvillim ekonomik për bizneset agrare dhe fermerët vendorë, me qëllim të rritjes së qasjes në tregun rajonal dhe stimulimin e zëvendësimit të importit.**

Për këtë qëllim Komuna, me bashkëfinancim me Komisioni Evropian, Zyra e BE-së në Kosovë, themeluan Tregut mobil për fermerë, duke synuar promovimin e prodhimit vendor. Përveç Komunës së Prishtinës, Komisionit Evropian dhe Zyra e BE-së në Kosovë, akterë kryesorë në projekt ishin edhe ARDA Qendër, Gratë në Biznes, CEED Kosova dhe ndërmarrja publike "Hortikultura".



Përmes tregut mobil përfituan në mënyra të ndryshme mijëra fermerë nga gjithë Kosova. Përmes këtij projekti u synua të krijohen mundësi të reja punësimi, veçanërisht për fermerët e rinj, me qëllim reduktimin e papunësisë, varfërisë dhe migrimit.

Hapja dhe funksionalizimi i 5 tregjeve mobile në Prishtinë, u bë në këto lagje: Tregu mobil në lagjen "Tophane", sheshi "Adem Jashari"; Tregu mobil në sheshin "Zahir Pajaziti", Tregu mobil në lagjen "Dardania", Tregu mobil në lagjen "Ulpiana" dhe Tregu mobil në lagjen "Taslixhe". Në këto 5 tregje mobile kanë shitur në treg rregullisht 120 fermerë. Gjatë gjithë vitit ky projekt ka mobilizuar afro 1.000 fermerë të Rajonit Qendër, të cilët kanë shitur produktet përmes fermerëve të tjera, shoqatave apo përpunuesve.



Përmes këtyre 5 tregjeve mobile, është arritur vetëdijesimi i fermerëve dhe konsumatorëve, po ashtu është inkurajuar integrimi i komponentëve gjinore.

Gjatë këtij projekti janë rritur kërkesat e konsumatorëve për produkte vendore.

Projekti ka dëshmuar se sektori i bujqësisë ofron potencial të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Investimi në këtë sektor krijon efekte zingjyrore në sektorët e tjera të ekonomisë.

Ky projekt është bashkë-financuar nga Komuna e Prishtinës dhe BE-ja. Shuma gjithsej e projektit: 479,397.45 euro. Kohëzgjatja e projektit 24 muaj, nga 17 dhjetori 2014 - 6 dhjetor 2016.

Komuna e Prishtinës bashkë me Zyrën e BE-së në Kosovë dhe me partnerë tjerë, do të avancojë bashkëpunimin dhe do të zhvillojë projekte të përbashkëta, duke përkrahur fermerët dhe duke institucionalizuar shitësit ilegalë përmes vendosjes së tyre në tregun mobil.

Pas përfundimit të projektit me Zyrën e BE-së, Komuna e Prishtinës ka vendosur që ta vazhdojë këtë projekt me resurset vetanake edhe viteve të ardhshme.



Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes së Shqipërisë, në kuadrin e programit të aktiviteteve të miratuara për festat kombëtare të muajit nëntor, për tri vite radhazi ka organizuar panairin tradicional "Blej Shqip". Traditë kjo shumë e qëlluar, e cila mundëson fuqizimin e prodhuesit shqiptar, informimin për prodhimet e njëri-tjetrit dhe gjetjen e formave të bashkëpunimit në mes tyre, duke tekaluar të gjitha barrierat e mundshme.



Si organizatore, Komuna e Prishtinës ka siguruar hapësirë ekspozuese me sipërfaqe 1,000 m<sup>2</sup> në total, me stenda të mbuluara, me pajisje përcjellëse të nevojshme. Për bizneset nga vendet tjera ka siguruar sipërfaqen prej 520m<sup>2</sup>.

Komuna e Prishtinës ka hartuar agjendën dhe programin e ceremonisë së inaugurimit të panairit. Ka kryer të gjitha njoftimet e nevojshme në nivel qendror dhe lokal, ka njoftuar autoritetet e sigurisë shtetërore, dhe përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ka krijuar lehtësira për bizneset nga trevat tjera shqiptare. Po ashtu, ka bërë njoftimin e medies vendore, të cilat e kanë mbuluar këtë ngjarje. Me anë të thirrjes publike, Komuna e Prishtinës ka njoftuar bizneset/prodhuesit nga Kosova që të aplikojnë për të marrë pjesë në panair, kurse nga bashkë organizatori ka pranuar listën e kompanive shqiptare.



Nga të dy palët, organizmi u cilësua si një traditë shumë e qëlluar, në mënyrë që të fuqizohet prodhuesi shqiptar, të informohen për prodhimet e njëri-tjetrit dhe të gjejnë format e bashkëpunimit në mes tyre, duke tejkaluar të gjitha barrierat e mundshme. Më këtë rast, Komuna e Prishtinës u vlerësua lart për krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e këtij panairi.

Gjatë gjithë panairit, Komuna e Prishtinës ka ofruar shërbime dhe asistencë përvizitorët dhe për pjesëmarrësit me prezencë të personelit të angazhuar në stenda. Përfaqësuesit e bizneseve u shprehen mirënjoħes dhe falenderues ndaj Komunës së Prishtinës për mundësinë e ofruar.



Komuna e Prishtinës me kapacitetet e veta financiare dhe të burimeve njerëzore, u kujdes për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërinstitucionale, me çdo subjekt privat ose publik, i cili ishte direkt ose indirekt palë e interesuar për panairin.

Ky panairi mbloodi në Prishtinë mbi 120 biznese/prodhues shqiptarë dhe u vizitua nga numër i madh i qytetarëve nga të gjitha trevat shqiptare.

Panairi "Blej Shqip" konsiderohet pjesë e rëndësishme e kalendarit institucional të Komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes së Shqipërisë.